



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 493

Datë: 20.10.2023

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të nenit 33 të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë: 11.09.2023 (nr.02/441, datë: 14.09.2023, nenin 20 pika b, të Rregullores nr.02/175 datë: 31.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve, dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë: 20.10.2023

THËRRET

Mbledhjen e -IX- (nëntë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023, e cila do të mbahet ditën e Hënë me datë: 23.10.2023 duke filluar nga ora :09:45.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Komisioneve

Ftohet z/zj _____ që të marr pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozojë këtë:

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë të rregullt e mbajtur me datë: 21.07.2023 dhe mbledhjes së shtatë të rregullt e mbajtur me datë: 24.08.2023.
2. Shqyrtimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2023.
3. Shqyrtimi i kërkesave
4. Të ndryshme.

Malishevë, tetor 2023

Kryesuesi i Kuvendit

Arifend Thaçi:



PRANUAR ME: 14.09.2023
ACCEPTED ON:
PRIMJENI
Nr. N. M. G. 02/442



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/_____
Datë: 14.09.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VI- (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt e mbajtur me datë: 23.05.2023 dhe mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë:29.06.2023.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qeshor 2023.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/317 datë:22.06.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore /komunale për realizimin e projekteve të KEDS për zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ndërtimin e trafostacioneve për regjionin e Komunës së Malishevës.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/960 datë:07.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik për komunën e Malishevës dhe fillimin e procedurës për bartjen e pronësisë së pronës së menaxhuar nga Institucionet Qendrore-Agjensioni Kosovar i Privatizimit, në emër dhe pronësi publik të Komunës së Malishevës.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë:3.5.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/382 datë:21.06.2023, për Ridestinimin e mjeteve për investime kapitale.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës.
- 8.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.
- 9.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023.
10. Shqyrtimi i kërkesave.
- 11.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 21.07.2023 dhe filloi në ora: 09:40. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi,Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, Muharrem Morina- zyrtar ligjor, antarët e komisionit: Gentianë Hoti, Hamit Lima,Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, Arlindë Rudi, përfaqësuesi nga OSBE Sead Raba dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!
Hapi mbledhjen e -VI- (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi 6 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. A e dëshiron dikush fjalën tek rendi i ditës?
Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!
Kryesues, desha disa sqarime tek pika e pestë kërkesa e Enver Mazrekut, ne e kemi votuar në Kuvend dhe e kemi hedhur poshtë dhe unë mendoj që është një vendim për këtë.
E dyta a ka nevojë tani me ngrit si qështje apo duhet në Kuvend për Valonin dhe Arsimin, për Komisionin që kemi qenë në fshatra.

Argjend Thaçi: Faleminderit, Veton!
Sa i përket Valonit dhe Arsimit direkt në Kuvend e ngrit si qështje.Tek pika e pestë ne kemi pasur mungesë të dokumentacionit dhe është plotësuar dokumentacioni sipas asaj që kërkohet për shpallje me interes të përgjithshëm dhe këmbim të pronës. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!
Konform Raportit të Auditorit duhet të vijë dhe Plani i Veprimit, qe ne i përgjigjum Auditorit dhe unë kërkojë që ky Plan të hyjë si pikë në rend të ditës.

Argjend Thaçi: Kush është për, që Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas rekomandimit të zyrës kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës për të gjeturat e vitit 2022, të hyjë në rend të ditës?

Me vota unanime, kjo pikë hynë në rend të ditës.

Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime, aprovohet rend i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt e mbajtur me datë: 23.05.2023 dhe mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë:29.06.2023. A keni diqka të shtoni rreth procesverbalit?

Nëse nuk e do askush fjalën shkojmë në votim. Kush është për miratimin e procesverbaleve?

Me vota unanime, miratohen procesverbalet.

Kalojmë në pikën e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qeshor 2023. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Buxheti i alokuar për këtë periudhë janar-qeshor 2023, kap shumën prej 14,513,788.35E, që do të thotë se shkalla e realizimit të buxhetit është 78.79%. Sipas të gjitha shënimeve të thesarit del se

shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar (alokuar) për periudhën janar-qeshor 2023 është 78.51% Si përqindje e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është 61.86%.

Sipas buxhetit për vitin 2023, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen 1,158,603.00E.

Sipas shënime aktuale për këtë periudhë janar-qeshor 2023, përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është 79.26%. Për njoftim pasqyrat e ditës së sotme prej të hyrave, duke mos përfshirë gjokat kemi kalu 1,000.000.00. Nëse na vinë dhe të hyrat nga gjokat në trafik dhe nga gjykata besoj që korriku është i përmbyllur me realizimin e të hyrave qindpërqind.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ajo që e kam përmendur dhe herave të tjera dhe po e theksoj dhe sot, që vërehet një rritje e madhe e planifikimit të të hyrave vetanake dhe ajo që kisha kërkuar është që me pas një lloj planifikimi dhe më të madh pasi tash ka një rritje, në mënyrë që deri në fund të vitit me pas një përqindje përtej limiteve që i kemi caktuar ne si Komunë.

Po ndalem më shumë të shpenzimet me i krahasu me vitin 2022. Kemi tabelen 7.4-shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike janar-qeshor 2023, i vërej disa kategori që ka rritje në krahasim me vitin 2022.

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, në krahasim me vitin 2022 që kanë qenë 120E, tani është shumfishuar.

Shpenzimet e telefonisë mobile në vitin 2022 ka qenë zero, ndërsa tani 6,000,00E.

Shpenzimet e internetit qenka një shumë paksa më e vogël. Shpenzimet për antarsim në vitin 2022 ka qenë 3,500.00E, ndërsa në vitin 2023 është 21,630.00E.

Shërbime të ndryshme intel në vitin 2022 ka qenë 11,040.00E, ndërsa në vitin 2023 janë 53,350.00E.

Shërbimet e arsimit trajnimet në vitin 2022 kanë qenë 990, ndërsa në vitin 2023 janë 3,705.60E.

Shërbime kontraktuese tjera në vitin 2022 kanë qenë 177,338.14, ndërsa në vitin 2023 janë 480,464.11E për qfarë kategorie bëhet fjalë.

Paisje specialistike mjeksore, zero ka qenë në vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 janë 30,000.00E.

Kompjuter në vitin 2022 janë 979 euro, ndërsa në vitin 2023 janë 26,768.00E.

Paisjet tjera nuk po e kuptoj në vitin 2022 kanë qenë 8,504.50, ndërsa në vitin 2023 janë 42,424.40E.

Furnizime zyre në vitin 2022 kanë qenë 19,955.26, ndërsa në vitin 2023 janë 33,696.37E.

Avans për udhetime zyrtare-të parën e kishim udhetime zyrtare që ishte 5,981.25E, ndërsa tani është 10,361.00E.

Karburant paskum zbritje, kjo ndoshta është e ka zbritur qmimi. Gaz natyror janë 10,000.00E.

Mirëmbajtja riparimi i automjeteve në vitin 2022 ka qenë 7,568.18E, ndërsa në vitin 2023 janë 16,108.97E.

Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve në vitin 2022 ka qenë 975, ndërsa në vitin 2023 janë 30,000.00E është shumëfish më e madhe.

Mirëmbajtje rutinore në vitin 2022 ka qenë 850, ndërsa në vitin 2023 janë 26,541.70E.

Dreka zyrtare në vitin 2022 kanë qenë 7,012.20, ndërsa në vitin 2023 janë 12,141.00E.

Vendime të gjykatave në vitin 2023 janë 9,104.18E. Këto kategorit që janë më të mëdha se në vitin 2022 do ishte mirë me i arsyu pse ka rritje në disa kategori të njehta. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Faleminderit, Veton! Urdhëro, Blerim!

Blerim Thaçi: Duke u nisur dhe te qështja e prezantimit që ka bërë matjet në nivel të vendit, që komuna e Malishevës për periudhën 3 mujore ka qenë njëra prej komunave të para që ka pasur realizimin e shpenzimit më të madh. Në këtë Raport 6 mujor hynë dhe shpenzimet e 3 mujorshit të parë.

Te qështja e shpenzimit zyrtarë jashtë vendit, unë po ju njoftoj që kemi pasur vizitë zyrtare në Amerikë bashkë me Kryetarin, vizitë zyrtare kanë pasur përfaqësuesit e Shërbimeve publike në Japoni dhe vizitë zyrtare kryetari ka pasur në Austri.

Te avanset janë qështje e shpenzimeve që i kanë kryer sektorët që shkojnë në udhetime zyrtare dhe tani me formular të ri nuk quhen meditje.

Te shërbimet e tjera kontraktuese hynë shumë shërbime, hynë konsulent dhe operatorët që kryejnë shërbime të pastrimit dhe operatorët që janë duke i kryer të shërbimeve që janë duke u kryer në shëndetësi.

Paisjet e tjera mjeksore në këtë vit ende nuk janë pajis dhe nuk është kryer furnizimi dhe nuk kemi bërë pagesa ose ka pasur qështje të kontraktuara më herët që kanë qenë kontrata dy vjeqare dhe janë realizuar në periudhën e gjashtëmujorit të parë.

Kompjuterët, përveq juve është dhe qështja e administratës që është furnizu.

Sa i përket druve realizimi i shpenzimit është kryer në gjashtë mujorin e parë të këtij viti duke i marrur obligimet për vitin 2021-2022-2023.

Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve është një diferencë më e madhe dhe kjo nuk është qështje që varet nga planifikimi i jonë se si do të ndodhë. Ka pasur intervenime të shumta në qështjen e veturave për atë është ky qmim.

Këto vendimet e gjkatave janë dhe ato të arsimit, por ka dhe vendime të tjera.

Veton Zogaj: Drejtor, me sa di unë Ministria e Arsimit e ka marrur një vendim për këtë qështjen e kontratave kolektive. Pse po zbatohet ende?

Muharrem Morina: Sepse pasojat janë të viteve të kaluara.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qeshor 2023?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën e tretë Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/317 datë:22.06.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore /komunale për realizimin e projekteve të KEDS për zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ndërtimin e trafostacioneve për regionin e Komunës së Malishevës. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Nga praktikat e kaluara kur vijnë këso kërkesa është mirë me ja bashkangjitur dhe kërkesa për formimin e një komisioni.

Muharrem Morina: Në rastin konkret nuk ka me pas procedurë. Vetëm kemi me dhënë në shfrytëzim, kemi me i caktuar tarifen KEDS-it se sa është vlera e metres katror, sepse ligji e lejon që për qështje energjetike nuk zhvillohet procedura. Problemi tjetër është se nëse këto prona ne i japim në shfrytëzim, këto prona nuk janë pjesë e vendimit të asambles të cilat komuna i ka paraparë me i dhënë për vitin 2023. Këtu ka mundësi Ministria me thënë që nuk e keni miratuar. Nëse na lejojnë me ja dhënë pronat, shkak i rëndësishëm që e kanë pronat për dhënien në shfrytëzim për rastin e KEDS-it, përmirsimin e kushteve energjetike në nivel të përgjithshëm ka mundësi që Ministria e anashkalon, përndryshe këto do të duhet të ishin pjesë e atij vendimi që komuna ka planifikuar me dhënë në këtë vit.

Gentianë Hoti: Kjo pra është e rëndësishme se çka po votojm pro dhe çka kundër.

Argjend Thaçi: Kush është për që kërkesa 02/37 të rekomanohet për Kuvend?

Për: 5

Kundër: 1

Abstenim: 0

Me 5 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/960 datë:07.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik për komunën e Malishevës dhe fillimin e procedurës për bartjen e pronësisë së pronës së menaxhuar nga Institucionet Qendrore-Agjensioni Kosovar i Privatizimit, në emër dhe pronësi publik të Komunës së Malishevës.

Muharrem Morina: Kjo është në pronësi AKP Mirusha, e cila është nën menaxhimin e AKP-së. Në rast që ju merrni vendim dhe shpallni zonë me interes të veçantë këto ngastra, pastaj vendimi i asambles përveq qertifikimit që duhet në Ministrinë e Pushtetit Lokal, duhet me kërkesë të Kryetarit me shku në qeveri e cila duhet me miratu këtë nismë të komunës, që pronat e AKP-së të cilat menaxhon OPB Mirusha me ja bart kuvendit komunal, pastaj komuna i menaxhon në bazë të projekteve të veta, strategjive që i parasheh me i zhvillu në atë pjesë.

Hamit Lima: A është e përfshirë e gjithë ajo pjesë.

Muharrem Morina: Vetëm airoporti është i përfshirë.

Hamit Lima: Kjo do ishte më mirë të bëhen komplet bashkë dhe të votohen të gjitha dhe jo pjesë pjesë.

Muharrem Morina: Kjo kryhet me një vlerësim financiar i cili i kushton shumë qeverisë për me i pagu këto prona, për arsye se një pjesë e këtyre mjeteve shkojnë në fondin e privatizimit dhe nga aty kalon tek ata njerëz që kanë punuar në ato ndërmarrje. Rreziku andej është sepse ka kontekste gjyqësore.

Hamit Lima: Kontekst gjyqësor e ki dhe këtë.

Muharrem Morina: Është e vërtetë ajo që e e thu t'i, mirëpo më lehtë e kalon me një pjesë të vogël.

Hamit Lima: Unë te kjo pikë kisha thënë mos me dërgu në kuvend, sepse këtu ka shumë gjëra që nuk janë të mira dhe si pikë është e ndjeshme.

Argjend Thaçi: Është mirë ne me e dërgu në Kuvend, meqenëse është e ndishme dhe janë në ngjare të gjithë anëtarët e kuvendit dhe qytetarët.

Veton Zogaj: Unë e mbështes Hamitin në këtë pikë sepse ka të drejtë dhe nuk është mirë të bëhet copa copa vendime-vendime. Nëse është me interes të madh për komunën, de ta merr komplet të paktën atë zonë.

Argjend Thaçi: Ne po e rekomandojmë për Kuvend me kërkesën që me u bashkangjit dhe pronat e tjera. Kush është për?

Për: 2

Kundër: 4

Abstenim:0

Kjo pikë nuk kalon.

Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë:3.5.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike.Është kërkesë që e kemi plotësuar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm që e kemi pasur në seancën e kaluar.Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Këtë pikë nuk është mirë me rekomandu për Kuvend, sepse ne kemi marrur vendim për këtë pikë të rendit të ditës dhe mos të riperseriten.

Argjend Thaçi: Veton, ne kemi marrur dhe vendime të tjera të cilat janë rishqyrtuar, sipas të cilës është kërkuar nga asamble komunale.

Veton Zogaj: Ne nuk kemi dhënë rekomandim kësaj me plotësuar, ne e kemi marrur vendimin që komuna nuk ka interes me dhënë një pronë publike që është në qendër dhe me marr një pronë që është komplet jashtë qytetit. Kjo ka qenë arsytimi i asambleistëve në Kuvend, dhe mbi këtë bazë kemi votuar kundër.

Muharrem Morina: Në aspektin procedural kërkesa është trajtuar dhe në mbledhjen e kaluar, ku Kuvendi nuk e ka dhënë votën për me kalu dhe pika ka rënë në pikën zero. Në aspektin procedural nuk ka asnjë vërejtje për me ardhë prapë dhe vendimarrja është e juaja pastaj. Zhvillimi procedurës që është bërë në rastrin konkret, Ligji thotë që këmbimi i pronës duhet të bëhet në një ngastër që janë në megjë. Ligji e lejon që dhe palët fizike me i bërë ofertë komunës për të bërë këmbim prone, siq i lejon komunës me i bërë ofertë.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend pikën nr.02/271 datë:3.5.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike?

Për: 3

Kundër: 3

Abstenim: 0

Kryesuesi me votë të dyfishtë përcakton votimin, i cili është për dhe kjo pikë rekomandohet për kuvend. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/382 datë:21.06.2023, për Ridestiminin e mjeteve për investime kapitale. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Kemi bërë kërkesën që këto mjete të barten në projekte të cilat janë duke u realizuar dhe janë të nevojshme për realizim. Kërkoj nga ju që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend që të realizohet kërkesa jonë. Në këtë kërkesë janë të gjitha projektet nga cilat kode kalojnë në kode tjera.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Është e drejtë legjitime e komunës që kërkon në fazat e përcaktuara me ligj ku i bart mjetet nga një projekt i caktum në projekte të tjera që i parasheh, mirëpo arsyeja pse vota ime ka me qenë kundër është mbi faktin që e kam thënë dhe kur është votuar buxheti që fokusi i komunës komplet është në dy projektet madhore. Mirë që po bëhen këto dy projekte, mirëpo me u dëmtu këto pak projekte nëpër fshatra për hirë të dy projekteve madhore në qytet nuk po e shohë të arsyeshme. Viti 2022 dhe 2023 kemi parë shumë pak investime kapitale dhe nuk po shohë të arsyeshme që këto pak projekte me i bartë në këto dy projekte. Projekti i ujësjellësit ky projekt këto mjete janë nga viti 2017-2018, futen në buxhet në shtator

dhe i merren mjetet në fazat tjera. Sikur të kishte një shpërndarje gjithëandej do ishte më e arsyeshme dhe ne kishum votuar për pa telashe.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Mjetet të cilat barten për ridestininim, po e nisi qështjen e parë të QKMF-ja ky projekt ka qenë dhe këtë vit i planifikuar për me u realizu, mirëpo ai është realizu vitin e kalum dhe mjetet e planifikuara kanë mbetur pa u shpenzu.

Te qështja e ujësjellësit nëpër fshatra është shkuar sipas planifikimit të tyre nëse bëhet rrjetizimi dhe nuk ka ujë, ne po e bëjmë një shpenzim të një investimi kapital por prapë realizimi i qëllimit nuk po kryhet sepse ujë nuk ka.

Te kolektori-kolektori është i kontraktum, mirëpo për me i fillu procedurat për këtë vit nuk e di a është gati Urbanizmi dhe nuk do të thotë që hiqet prej projekti, sepse vitin e ardhshëm do të planifikohet dhe realizimi i kolektorit. Tek kjo pjesë e kolektorit gjithqysh do të rregullohet planifikohet dhe vitin e ardhshëm, ndërsa te ujësjellësi shohim si do të vepohet me Drejtorin e Urbanizmit, ata e kanë pjesën e realizimit të projektit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Te rruga "Ibrahim Mazreku" ne i kemi ndarë mjetet që është e parapamë për komplet projektin dhe tani që po kërkohet mjete shtesë a ka dalur jashtë asaj më tepër apo për qka duhen mjetet shtesë.

Blerim Thaçi: Te projekti "Ibrahim Mazreku", me qit mjete më shumë se sa është e planifikuar në bazë të kontratës nuk mundesh. Kjo shtesë është për me mbulu këtë 3,000,000.00E.

Hamit Lima: Te këto ridestininimet dhe në vitin e kalum e ke pasur të këto të hyra prej muzeut të Banjës i kemi ndarë 20,000,00E me e rregullu dhe veq 10,000.00E janë ndarë dhe 10,000.00si bëhet. Rregulimi i oborrit në Astrazup ka qenë 50,000.00E të ndara dhe tani janë 27,000.00E.

Blerim Thaçi: Është e vërtetë që 50,000.00E ka qenë për shkollën në Astrazup-zyra e prokurimit kur i shpallë tenderat me natyrë të njëjtë të renovimit të shkollave ose rregullimin e oborreve të shkollave, fushave sportive, ata e bëjnë një shpallje një kontrat për të gjitha këto. Kur të bëhet një kontrat ne mjetet duhet me i marr prej Astrazupit, Guriqit, Banjës. Ai i ka kry realizimin e punimeve në Guriq dhe në qoftë në Banjë dhe neve na vjen fakturat dhe ne e kemi një kategori të mjeteve që duhet me i marr në bazë të kontratës dhe në bazë të kontratës është dhe Astrazupi dhe i kemi marrur mjetet prej Astrazupit.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend të kërkesës nr.04/382 datë:21.06.2023, për Ridestininim e mjeteve për investime kapitale?

Për: 3

Kundër: 3

Abstenim: 0 Kryesuesi ka votë të dyfishtë dhe është për, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës. Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina: Këtu është ajo procedura që thash më herët, në këtë rast nuk ka kërkuar qytetari por ne i kemi kërkuar qytetarit. Është një pjesë tek ura, një pjesë e shkallve kur neve na duhet me zgjeru urën me ja marr. Me rastin e dy qytetarëve që që ja kemi marrur për me ja hequr shkallët atyre me zgjeru urën dhe trotuarin ja kemi ofruar si kompenzim prej pronës publike.

Argjend Thaçi: Kush është për që të rekomandohet për Kuvend kërkesa nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës?

Për: 5

Kundër: 1

Abstënim: 0 Me 5 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstënim kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Mbi 11 rekomandime që i ka dhënë auditori për 2021,6 janë realizuar dhe 5 janë në përmirsim, janë ripërsërit mirëpo janë në përmirsim, tre janë të reja. Për vitin 2021 Raporti ka qenë i kualifikuar mbi bazën e prezantimit të pasurive financiare të pasurisë dhe të e-pasurisë, atje ka qenë të mungesa e zyrtarit për futjen e të dhënave në sistem për pasuri dhe E-pasuri dhe aty është plotësuar me zyrtar dhe është punuar që sot të jetë e mundur të sillët në kuvend Raportin. 3rekomandimet e reja të raportit të auditorit janë nga zyra e prokurimit, që është qëshjtje e disa specifikave teknike gjatë procesit të tenderimit të projekteve. Si rekomandim që ne e kemi dhënë dhe arsyeshmërinë të Raporti i Auditorit është dhe vonesa e pagesave të fakturave të pranuar që kanë qenë në vitin 2021 dhe është kërkuar pagesa në vitin 2022, por ne nuk kemi mundur me i ekzekutu pagesat kur nuk kemi pasur kod në vitin 2022 dhe ka mbetur pa u paguar dhe në këtë periudhë që e ka përmendur dhe auditori. Qëshjtjet tjera janë prezantuar në Planin e veprimit të cilat ddo të merren për bazë rekomandimeve të auditorit që të përmirsohen në këtë vit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Vetoni!

Veton Zogaj: E mira është që ka përmirsim prej Raportit të vitit 2021, dhe e keqja është që prapë ne nuk përfitojmë nga granti qëveritar për shkak të disa rekomandimeve që nuk i kemi përmirsuar.

Argjend Thaçi: Katër janë elementare për të hyrë në kualifikime dhe ne i plotësojmë ato. Kush është për rekomandim për Kuvend, Raportin e Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023.

Gentianë Hoti: Drejtori, ka rast vdekje.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend, Raportin gjashtëmujor të Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër të Plani i Veprimit. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Janë të prezantuar këto 8 rekomandime dhe ne e kemi bërë dhe Planin me përmirsim të këtyre rekomandimeve.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend, Planin e Veprimit?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë te shqyrtimi i kërkesave. Kërkesa nr.02/202 datë: 14.04.2023 e parashtruar nga Driton Krasniqi, i cili kërkon nga asamblea komunale që të ja aprovon kërkesën për punimet e lapidarit të babait të vvarë në luftë, mësuesit Jashar Krasniqi nga fshati Tërpezë e Poshtme. Aty ku do të punohet lapidari është pronë e komunës dhe kërkoj aprovimin nga ana juaj. Meqenëse dhe nënshkrimet i ka marrë ne po e rekomandojmë për Kuvend. Kush është për?

Me vota unanime, kjo pikë kalon.

Kalojmë te kërkesa tjetër është Shera Morina nga fshati Gullbovc- e sëmur rëndë me sëmundjen e sheqerit si dhe sëmundjet e tjera me të cilat vuaj qe një kohë të gjatë. Gjendja ime shëndetësore dhe ajo materiale është shumë e rëndë, jemi 7 anëtarë të familjes dhe asnjëri nuk jemi të punësuar.

Kërkesa tjetër është Rustem Krasniqi nga fshati Drenoc, për arsye të sëmundjeve të shumta, kronike, të zemres, humbje të vetëdijes, probleme me boshtin kurrizor kërkoj ndihmë financiare nga KPF-ja. Jam në skem sociale por nuk janë të hyra të mjaftueshme për ti mbuluar shpenzimet.

Kërkesa tjetër është Sadbere Bellani nga fshati Lladroviq qe kater vite është e palëvizshme.

Kërkesa tjetër është Premton Limaj kërkoj nga komiteti për Politikë e Financa për shkak të kushteve jo të mira dhe më shumë se dy vite kam thyer këmbë e djathtë dhe nga atëherë kam vështërsi shëndetësore dhe 1 pa punë.

Kush është për që kërkesa nga Shera Morina, Rustem Krasniqi, Sadbere Bellani dhe Premton Limaj të ndahen nga 450euro?

Me vota unanime, këtyre kërkesave ju ndahen nga 450 euro.

Kërkesa tjetër është Meleqe Paqarizi e cila kërkon ndihmë financiare për ndihmë financiare pasi kam hequr njërin sy prej sëmundjes së kancerit dhe kam shpenzime të mëdha dhe nuk po mundem ti përballoj.

Kërkesa tjetër është Feride Robaj, e cila është e sëmur me probleme psikologjike, kriza të vetëdijes, marramendje dhe rënje të fikët. Për shkak të kontrollave të shpeshta dhe gjendjes ekonomike nuk po mundem ti përballoj shpenzimet dhe kërkoj ndihmë nga ana juaj.

Kërkesa tjetër është Tahir Ibrahim, invalid i luftës për shkak të pamundësisë për shërim kërkoj nga KPF-ja të më ndihmojë.

Kush është për që kërkesat nga Meleqe Paqarizi, Feride Robaj dhe Tahir Ibrahim ti ndahen shumat nga 450euro?

Me vota unanime, këtyre kërkesave ju ndahen nga 450euro.

Kërkesa tjetër është nr.02/44 nga gastronomët kryesisht bizneseve me shisha bare, kërkesë për iniciimin e procedurave për ndryshimin e vendimit të Kuvendit nr.02/500 datë: 24.10.2022, vendimi i cili ju ndalon shërbimin me shishen argil dhe të ngjajshme subjekteve të gastronomisë. Ne si biznese jemi shumë të prekura dhe të dëmtuara nga ky vendim madje nëse vazhdohet kështu me implementimin e këtij vendimi

dhe me gjobat që jemi duke i marrur nga organet e komunës ju informojmë që jemi pranë falimentimit dhe mbylljes së bizneseve, Kërkojm nga KPF-ja që kjo kërkesë të përcillet në Kuvend dhe aty të bëhet ndryshimi i vendimit dhe të na jepni mundësi të operojmë me këto shërbime dhe nëse jo sipas orarit të më parshëm, atëherë gjatë ditëve të javës kur nxënësit janë shkollë në to mund të punojmë pas orarit të orës 19:00 si dhe gjatë ditëve të vikendit. Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima: Sa i përket kësaj çdo ditë e më shumë është duke u bërë e pamundshme me u leju këta, duke e llogaritur sheshin, sepse deri në ora 12:00 janë po këta njerëz dhe më shumë ke të ri. Unë i kisha ndalu dhe kto lokalet- marketet që po i shesin këto, sepse ato janë drejtim i drogës, sepse varësi kanë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Është e vërtetë që këta përfaqësuesit e këtyre bizneseve më kanë shënu dhe disa prej tyre i kam taku dhe personalisht. Ne si grup i VV-së në parim e kemi votuar për me i ndalu, pa i pasur disa informacione të cilat i kam marrur së bashku me pronarët e këtyre bizneseve, por dhe me përfaqësuesit e Ministries. Këto vendimet shabllon që i merr siç i kemi marrur ne si Kuvend, përveq që i dëmton këto biznese, realisht i kemi marrur pak për ngut dhe me ja lehtësuar punën pak Inspektoriatit, sepse Inspektoriati e ka për detyrë me i inspektu ato. Njëri nga këta e ka licencën nga Ministria që i furnizon gjitha lokalet e kësaj kategorie në të gjithë Kosovën. Këta kanë kërkuar pas orës 19:00 dhe ditëve të vikendit të punohet me shisha. Në atë vendim ja vendos disa kritere psh me punu shtune-diele ose pas orës 19:00 dhe nëse hasen nën moshë 18 vjeq përsonat që po ju shërben këto pije pastaj dënoje dhe jo shabllon dhe po falimenton si biznes.

Hamit Lima: Këtë nuk e ke ndalu, mirëpo e ke caktu një distancë.

Veton Zogaj: Vendimi i asambles është i njëanshëm.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Vendimin më të mirë që e ka marrur komuna është ky për shisha. Ne e kemi caktuar një distancë që ndalohen shishat afër shkollës dhe stacionit, dhe kam informacion që dhe Orientali dhe Alfa janë duke e hapur më larg shkollës dhe aty nuk po ja ndalon është larg shkollës larg stacionit. Unë jam kundër kësaj kërkesë, sepse më mirë është të jetë afër shkollës një bibliotek sesa shisha baret e alkoholet në dëm të nxënësve tanë.

Veton Zogaj: Kjo është në dëm të bizneseve të caktuara, dhe kjo kërkesë është legjitime dhe duhet të shkojë në Kuvend.

Sadik Vrenezi: Është mirë këtë pikë më dërgu në Kuvend.

Veton Zogaj: Me dërgu në Kuvend dhe Kuvendi le të vendos kritere të tjera psh kriter që më pëlqej i tyre ishte me punu shtune diele dhe nëse ai e ka caktu pas orës 19:00 ne si Kuvend mundemi me ba pas orës 21:00.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesën nr.02/404?

Për: 3

Kundër: 3

Kryesuesi ka votë të dyfishtë dhe kjo pikë nuk kalon.

Te pika të ndryshme a e dëshiron dikush fjalën?
Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Është një kërkesë e dy familjeve të burgosurve në Maqedoni është bërë në muajin mars, është mirë të e trajtojmë në mbledhjen e ardhshme.

Argjend Thaçi: Në mbledhjen e ardhshme e diskutojmë. Faleminderit për prezencën, këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Përfundoi në ora: 12:15.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Nr. 02/ 446
Datë: 15.09.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VII- (shtatë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Statutit të Komunës së Malishevës.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të DKAË, për fillimin e vitit shkollor 2023/2024.
- 3.Shqyrtimi i kërkesave.
4. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 24.08.2023 dhe filloi në ora: 09:50. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Hamit Lima, Veton Zogaj, Sadik Vrenezi, përfaqësuesi nga OSBE Salih Elshani dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përsëritet për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -VII- (shtatë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Aktualisht prezent në mbledhje jemi 5 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Statutit të Komunës së Malishevës. Pas përfundimit të të gjitha procedurave dhe pas një pune të mirë të Komisionit, i cili ka qenë i formuar nga të gjitha partit politike, nga shoqria civile dhe nga zyra e kryetarit dhe kemi ardhur tek një përfundim që të përfundohet ky Statut. Gjithqka qka ka rrjedhur ka qenë me një votë unanime, madje dhe mbledhjet të cilat i kam thirrur si kryesues, nuk i kam mbajtur mbledhjen nëse kanë munguar më shumë se dy anëtarë. E falenderoj secilin anëtarë të komisionit për punën e bërë. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përsëritet për të gjithë!

Pajtohem me kryesuesin me këto që i tha, sepse si Komision nga dita e parë gjitha ndryshimet që

i kemi bërë janë bërë në mënyrë unifikuese dhe nuk kemi pasur telashe. Me një arsyetim të shkurtër pse nuk e kisha rekomandu për Kuvend është sepse ne si Komision jemi themeluar në vitin 2022 dhe një pjesë të mbledhjeve i kemi mbajtur në vitin 2022, ndërsa pjesën tjetër të mbledhjeve i kemi mbajtur në vitin 2023 dhe nuk jemi paguar për punën e bërë. Është momenti i fundit që duhet me reflektu pak, nëse kërkohet punë vullnetare ne si kuvend e nxjerrim një vendim që po formojnë një komision i cili është themeluar mbi bazën vullnetare mandje kush e ka gadishmërin shkojmë aty dhe jemi në rregull. Vetëm nëse një vendim e nxjerr Kuvendi e formon një komision, ja cakton dhe vlerën për shumën që do të paguhen anëtarët e komisionit dhe për një vit kalendarik nuk paguhesh, kjo nuk është në rregull.

Argjend Thaçi: Pasi prej mallrave dhe shërbimeve ka probleme me pagesat, atëherë zyra e personelit na ka kërkuar që pagesat të bëhen prej pagave dhe medijëve. Unë kam garanci që dhe për këtë dhe për komisionet tjera pagesat do të bëhen.

Veton Zogaj: Na jemi anëtarë të Kuvendit dhe e kemi një pagë, mirëpo ne kemi angazhuar si subjekt dhe njerëz jashtë dhe presioni i tyre po është ndaj nesh, sepse ata po mendojnë që ne po paguhum e ata jo.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi: Është bërë një punë e mirë nga ky Komision.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend, Statutin e komunës së Malishevës?

Për: 4

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 4 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të DKAË, për fillimin e vitit shkollor 2023/2024. Këtë pikë e kishim rekomandu për Kuvend, sepse stafi i arsimit janë në intervista. Kush është për rekomandim për Kuvend?

Me vota unanime, rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë te pika e 3 shqyrtimi i kërkesave: Kemi një kërkesë nga Shkelzen Kryeziu nga fshati Bubavec, të bashkangjitur ka Raportin e Drejtorisë së Emergjencave. Me datë 18.02.2023 rreth orës:19:55 është shkaktuar zjarr në fshatin Bubavec ku shtëpia është djegur në tërësi dhe është jashtë standartit për banimit, shkaktar i zjarrit dyshohet të jetë rryma elektrike. Unë propozoj që këtë kërkesë me rekomandu për Kuvend. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Sami Thaçi nga fshati Mirushë. Të bashkangjitur ka dhe Raportin e zjarrit nga Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim. Me datë:13.08.2023 rreth orës:20:26 është shkaktuar zjarrë në fshatin Mirushë ku janë përfshirë nga flaka një objekt banimi, odë, stallë bagëtish, ushqim bagëtish me dimensione 11x5 dhe shkaktar i zjarrit dyshohet të jetë rryma elektrike.Unë propozoj që dhe kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime dhe kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Azize Buzhala, e cila përballet me dializë, humbje të shpeshta të vetëdijes të

bashkangjitur keni dhe kontrollat dhe terapit. Kërkojë që ti ndahen mjetet prej 450E. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahet shuma prej 450E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 450E

Kërkesa tjetër është nga Bekim Krasniqi, i cili është pronar posedues i paluajshmërisë sipas lëndës nr.1269/22 sipas ngastrës P-72310075-00014-0 në vendin e quajtur RREZE, zona kadastrale Tërpezë, si dhe ngastra P-72310075-00015-0 në vendin e quajtur RREZE, zona kadastrale Tërpezë.. Komuna e Malishevës është pronare e pasurisë sipas nr të lëndës 1269/22 me nr të njësisë P-72310075-00013-0 zona kadastrale Tërpezë. Duke pasur parasysh se këto ngastra janë fqinje njëra me tjetrën dhe se pala Bekim Krasniqi gjatë punimit të ngastrës së tij ai dhe paraardhësit e tij ka mundur të vie deri te humbja e sinorëve edhe pse për këtë pala nuk ka mundur të dijë saktë. Në gusht të vitit pala fillon dhe e ndërton shtëpinë e banimit në ngastrën e tij dhe të njëjtën e përfundon. Kohën e fundit pas inspektimit të pronës dhe shikimit të saj kemi vërejtur se një pjesë e shtëpisë tonë ka dalur që të jetë në ngastrën e komunës së Malishevës. Ky gabim ka ndodhur për shkak të konfiguracionit të pronave. Duke pasur parasysh se unë jam fqinje me juve atëherë jap pëlqimin që të bëhet ndërrimi i ngastrave respektivisht i pjesës të sipërfaqeve të tyre ashtu siq e përcakton eksperti i gjeodezis pasi të dalë në teren.

Rukije Bytyqi: Ky e ka ndërtu nga asfalti e tash po do me ja lëshu komunës mbrapa.

Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesa e Bekim Krsasniqi?

Për: 0

Kundër: 4

Abstenim: 1

Kjo pikë nuk rekomandohet për Kuvend

Kërkesa tjetër është nga Liridon Gashi nga fshati Balincë identifikues i fermës 1053925, një stall bagëtish, ushqim bagëtish për përfshirë nga flaka në fshatin Balincë nga zjarri i rënë është lënduar lehtë dhe një anëtar i familjes që është 12 vjeq. Kush është që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Kajtaz Berisha nga fshati Carravranë, i cili kërkon ndihmë financiare pasi është i sëmurë me sëmundje kancerogjene të cilat e vërtetojnë dhe dokumentet e mjekut. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?

Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është Xhevrik Ramaj, e cila vuan nga kanceri dhe është kërkesë e muajit të tretë. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është nga Shefket Zabelaj vuaj dialza, probleme me shikim, stenda në zemër, nga diabeti he këmbën e djathtë e kam të shkëputur nga gjymtyra e trupit të impotuar si dhe gishtrinjë e këmbës së majt të impotuar. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 500E.

Kërkesa tjetër është nga Veli Binishi vuaj nga sëmundja e epilepsies, e cila duhet të trajtohet me terapi të rregullt dhe kërkoj ndihmë financiare. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 500E?


Me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 500E.

A e dëshiron fjalën dikush tek pika të ndryshme?
Nëse nuk ka diskutues këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.


Përfundoi në ora: 10:25.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina







PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 16/10/2023
PRILJEND:
Nr.No. 04/201

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE PËR PËRIUDHËN JANAR-SHTATOR 2023



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
Raporti periodik i Informatave Menaxheriale për Kryetarin, Kuvendi Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financë.....	4
TË HYRAT.....	3
1. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas burimeve Tab. 1.....	3
1.1. Shkalla e alokimit të buxhetit për vitin 2023 Grafiku. 1.....	3
2. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas kategorive ekonomike Tab. 2.....	4
2.1.Realizimi i të hyrave sipas kategorive ekonomike për PR.Grafiku 2.....	4
3. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas Drejtorive Tab. 3.	6
4. Të hyrat vetanake sipas drejtorive dhe kodeve ekonomike Tab. 4.	6
4.1. Të hyrat vetanake të planifikuara,të realizuara në PR 2023.Grafiku . 3.....	9
4.2. Të hyrat vetanake në mënyrë analitike Tab. 4.1.....	10
SHPENZIMET.....	12
5. Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit Tab. 5.	12
6. Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike Tab. 6.....	12
6.1. Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike Grafiku. 4.....	13
6.2. Shpenzimet për paga dhe mëditje në mënyrë analitike janar-shtator 2023. Tab. 6.1.....	12
6.3. Shpenzimet për shërbimet komunale në mënyrë analitike janar-shtator 2023. Tab. 6.2.....	13
6.4. Shpenzimet për subvencione dhe transfere në mënyrë analitike janar-shtator 2023. Tab. 6.3. Error! Bookmark not defined. 14	
6.6. Shpenzimet për investimet kapitale në mënyrë analitike janar-shtator 2023 Tab. 6.5.....	15
7. Përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të drejtorive komunale.Tab 6.6.....	15
7.1. Shpenzimet sipas drejtorive janar-shtator për vitin 2023. Tab. 6.7.....	25
PROJEKTET KAPITALE.....	26
8.1. Projektet kapitale të Drejtorisë për Administratë Tab. 8.1.	26
8.2. Projektet kapitale të Drejtorisë për shërbime publike Tab. 8.2.....	27
8.3. Projektet kapitale të Drejtorisë për planifikim urban dhe mjedisi Tab. 8.3.....	26
8.4. Projektet kapitale të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenje sociale Tab. 8.4.....	28
8.5. Projektet kapitale të Shërbimeve sociale dhe rezidenciale Tab. 8.5.....	29
8.6.Projektet kapitale të Drejtorisë për kulturë,rini dhe sport.....	27
8.7. Projektet kapitale të Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë Tab. 8.7.....	30
8.8. Projektet kapitale prej Donacioneve të ndryshme Tab. 8.8.	309
8.9. Burimet e financimit të projekteve kapitale në total. Tab. 8.9.....	32

HYRJE

Në bazë të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048 si dhe Ligjit nr.03/L-221 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-048, gjegjësisht nenit 6.3,6.4 si dhe nenit 45, për raportimet vjetore dhe periodike mbi menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, Organizatat buxhetore janë të obliguara ti paraqesin raportet periodike dhe përfundimtare financiare.

Prandaj Drejtoria për Buxhet dhe financa ka përpiluar raportin financiar për periudhën **Janar-shtator 2023** në bazë të standardeve të Kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura në këtë periudhë.

Sipas të dhënave të prezentuara në tabelat përkatëse del se K.K-Malishevë ka një buxhet të miratur nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal-2023, në shumën prej **18,124,837.00€** për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj i shtohen bartjet e disa shumave të vogla të donacioneve të mbetura nga vitet e kaluara në shumë prej **1,140.35€** të regjistruara në SIMFK, del se shuma totale e buxhetit është **18,125,977.35€**. Kësaj shume i shtohet edhe shuma prej **7,523.16€** rritje e pagave sipas ligjit të pagave, **286,373.78€** të hyrat e bartura nga viti **2022**, si dhe tejkalimi i të hyrave vetanake për **169,263.12€**, del se buxheti i tërësishëm i futur në SIMFK si buxhet aktual përfundimtar kap shumën prej **18,589,137.41€**.

-Buxheti i alokuar për këtë periudhë (Janar-shtator 2023), kap shumën prej **17,514,329.04€** çka do të thotë se shkalla e realizimit (alokimit të buxhetit total është **94.22%**.

-Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar (alokuar) për periudhën janar-shtator 2023 është $(15,898,052.72/17,514,329.04) \times 100 = 90.77\%$.

-Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është: $(15,898,052.72/18,589,137.41) \times 100 = 85.52\%$.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit, realizimi dhe shpenzimi i tij sipas programeve, sipas burimeve (fondeve), sipas kategorive ekonomike dhe sipas drejtorive në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar-shtator 2023.

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2023, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen, **1,158,603.00€**.

Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën Janar-shtator 2023, është: të hyrat e rregullta janë **1,307,798.42€**. Këto të hyra janë të futura në sistem dhe të planifikuarat janë alokuar, kurse gjobat në trafik për janar-shtator kapin shumën e **157,096.00€**, kurse gjobat e gjykatave në këtë periudhë janë **34,613.33€**. Të hyra nga agjencioni pyjor i Kosovës për këtë periudhë nuk ka patur. Pra të hyrat e gjithëmbarshme, vetanake të realizuara për këtë periudhë kapin shumën prej **1,499,507.75€**.

Pra sipas shënimeve aktuale, në këtë periudhë pra janar-shtator 2023, përqindja e realizimit të të hyrave vetanake në krahasim me planifikimin është $(1,499,507.75/1,158,603.00) \times 100 = 129.42\%$, që dmth, kemi një tejkalim të planifikimit për **340,904.75€** ose **29.42%**.

Drejtoria për buxhet dhe financa




RAPORTI PERIODIK I INFORMATAVE MENAXHERIALE PËR KRYETARIN, KUVENDI KOMUNAL, KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA

TË HYRAT

1. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas burimeve Tab. 1.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2023	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2022
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Fin. nga Huamarrjet	4			#DIV/0!	13,035,751.40
Granti Qeveritar	10	16,973,757.16	16,068,213.91	94.67	843,634.13
Të hyrat vetanake	21	1,327,866.12	1,158,601.00	87.25	640,428.84
Mjetet e bartura	22	286,373.78	286,373.78	100.00	412.97
Donacionet e brendshme	31	412.97	412.97	100.00	727.38
Donacionet e jashtme	32	727.38	727.38	100.00	
TOTALI		18,589,137.41	17,514,329.04	94.22	14,520,954.72

1.1.Shkalla e alokimit të buxhetit për vitin 2022 Grafiku. 1.




Nga tabela e më sipërme shifet se buxheti përfundimtar për vitin -2023 është 18,589,137.41€. Shuma totale e buxhetit të miratuar është 18,124,837.00€ , shuma prej 1,140.35€ është nga disa shuma të vogla të mbetura të donacioneve nga vitet paraprake,,shuma prej 7,523.16€ shtesa në paga sipas ligjit të pagave,bartja e THV nga 2022 në shumë prej 286,373.78€,si dhe tejkalimi i THV për 169,263.12€ e rrisin buxhetin total në SIMFK në 18,589,137.41€

2. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas kodeve ekonomike Tab. 2.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
		Buxheti i planifikuar për vitin 2023	Të hyrat e realizuara (alokuara) në PR 2023	Përqindja e buxhetit të realizuar në PR 2023	Të hyrat e realizuara (alokuara) në të njëjtën periudhë 2022
1	2	3	4	5=4/3*100	6
		€	€	%	€
Paga dhe meditje	11	9,407,470.66	8,501,927.41	90.37	7,005,122.90
Mallra dhe shërbime	13	2,040,857.41	2,040,855.41	100.00	1,761,188.58
Komunali	14	655,000.00	655,000.00	100.00	455,000.00
Subvencione dhe trans fere	20	700,834.77	700,834.77	100.00	500,000.00
Investimet kapitale	30	5,784,974.57	5,615,711.45	97.07	4,799,643.24
				#DIV/0!	
TOTALI		18,589,137.41	17,514,329.04	94.22	14,520,954.72

Në këtë tabelë është dhënë buxheti dhe realizimi (alokimi) i tij sipas pesë kategorive ekonomike si dhe krahasimi sipas periudhës së njëjt të vitit të kaluar. Pra për periudhën janar-shtator 2021 është alokuar shuma prej 12,926,371.61€.

2.1.Realizimi i të hyrave sipas kategorive ekonomike Janar-shtator 2022.Grafiku 2.



3. Përmbledhja e të hyrave Komunale sipas Drejtorive Tab. 3.

Përshkrimi	Kodi	Përiudha raportuese (PR)			Viti paraprak
